


# Park4SUMP

Si mund t   
ndryshoj  imazhi i  
qytetit tuaj nga  
menaxhimi i  
parkimit



Projekti Park4SUMP  sht  financuar nga BE n  kuad r t  Programit Horizon 2020 dhe ka p r q llim t  tregoj  se si qytetet mund t  p rshtasin politikat e menaxhimit t  parkimit dhe t  vendosin zgjidhje efektive dhe inovative si pjes  e Planit t  L evizshm ris  s  Q endrueshme Urbane. Ky projekt ka marr  fonde nga Planet Evropiane t  L evizshm ris  (SUMPs).

# Rezultatet kryesore të Park4SUMP

- 1 16 qytete partnere do të përmirësojnë politikat e tyre të parkimit dhe do të pilotojnë zbatimin e më shumë se 50 zgjidhjeve të mira të menaxhimit të parkimit
- 2 14 qeveri kombëtare do të rrisin njohuritë se si ligjet dhe rregulloret e nivelit të lartë të qeverisë lehtësojnë ose pengojnë përdorimin e menaxhimit inovativ dhe efektiv të parkimit në qytetet e tyre
- 3 Qytetet ndjekëse të jashtme do të përfitojnë nga ngritura e kapaciteteve dhe shfrytëzimi i rezultateve nga përmirësimi i integrimit të politikave të parkimit dhe të SUMP-it dhe të zbatimit të rreth 300 qasjeve të menaxhimit të parkimit
- 4 Zhvillimi i një politike të parkimit dhe i një mjeti auditimi të menaxhimit të, PARKPAD, dhe pilotimi i tij në 16 qytete Park4SUMP
- 5 PARKPAD monitoron në të gjitha qytetet partnere dhe 10 qytete tjera (jashtë konsorciumit)
- 6 Program trajnimi Park4SUMP të posaçme (ngjarjet kombëtare të trajnimit dhe webinarët) për autoritetet lokale, rajonale dhe kombëtare në 16 vende

## Masa lokale Park4SUMP

- 1 Zbatimi i parkimit me pagesë për here të parë në qytet
- 2 Menaximi i parkimit do të integrohet ne Projekt-Studimin e Trafikut dhe Lëvizshmërisë së Qendrueshme Urbane të Qytetit të Shkodrës
- 3 Një pjesë e të ardhurave do të shpenzohen për përmirësimin e çështjeve të Levizshmërisë Urbane


# Pse Park4SUMP?

Zgjidhje tē reja parkimi mund tē bëhen pjesë integrale tē Planit tē Lëvizshmërisë Urbane tē Qëndrueshme (SUMP) pér tē arritur vizionin dhe objektivat e qytetit tuaj.

Mësoni nga qytetet kryesore dhe ekspertët tanë ndërkombëtarë se si tē:

- ▶ Lëvizni nga një planifikim parkimi operativ ahe reaktiv, në një planifikim më strategjik
- ▶ Zbatoni zgjidhje inovative dhe më pak tē kushtueshme tē parkimit
- ▶ Kanalizoni tē ardhurat e parkimit pér investime në Lëvizshmërinë Urbane (transport publik, bicikleta, ecje, etj.)
- ▶ Rrissni pranimin politik dhe publik tē zgjidhjeve tē menaxhimit tē parkimit
- ▶ Lironi hapësirat publike nga presioni i parkimit tē automjeteve, pér tē përmirësuar cilësinë e jetës në qytetin tuaj
- ▶ Reduktoni qarkullimin e makinave, si rezultat i zgjidhjeve tē menaxhimit tē parkimit, pér ta bërë sistemin tuaj tē transportit sa më tē qëndrueshëm

Punoni me ne pér tē inkurajuar vendimmarrësit e nivelit tē lartë tē qeverisë pér tē lejuar dhe mbështetur zgjidhjet tē reja dhe efektive tē menaxhimit tē parkimit në qytete.



# Qytetet Park4SUMP

16 qytete evropiane janë bërë bashkë, me 6 partnerët tanë teknik dhe 3 organizata kërkimore dhe parkimi, për të demonstruar dhe transferuar përfitimet nga parkimi i menaxhuar strategjikisht dhe me zguarsi në një lëvizshmëri të qëndrueshme urbane.

 Qytetet Drejtuese

 Partnerët Teknikë

 Qytetet Mësimore

 Bordi Këshillimor

## Metodologjia e Park4SUMP

Metodologjia e projektit tonë bazohet në këshillimin dhe mbështetjen e qyteteve të tjera në evropë.

Është hartuar në grupet e mëposhtme:

- ▶ Rritja e ndërgjegjësimit dhe e pranimit ndërmjet palëve të interesuara mbi atë se si politikat e “parkimit të duhur” mund të ndihmojnë qytetet
- ▶ Kalimi nga një politikë reaktive drejt një politike strategjike të parkimit
- ▶ Integrimi i menaxhimit të parkimit në SUMP
- ▶ Ndërtimi i kapaciteteve, veçanërisht ndërmjet qyteteve që kanë vështirësi në marrjen përsipër të këtyre politikave
- ▶ Nxitja e mëtejshme e risive në menaxhimin e parkimit.
- ▶ Përcjellja e ndryshimit të sjelljes, ndërkohë që krijohen të ardhura për tu investuar në zgjidhjet e mobilitetit të qëndrueshëm
- ▶ Zbatimi i masave të reja të parkimit për qytetet dhe të mësuarit nga shembujt dhe praktikat më të mira për një transferim efektiv të politikave ndërmjet qyteteve



# Instrumenti PARKPAD

Një lojë e vërtetë ndryshimi në menaxhimin e parkimit urban do të jetë zhvillimi i një instrumenti të ri PARKPAD.

Ai siguron një proces të auditimit që i ndihmon qytetet të rishikojnë politikat e tyre të parkimit dhe strukturën e tyre organizative, si dhe për të arritur konsensus mbi këto përmirësimë, duke zhvilluar një plan veprimi për menaxhimin e parkimit si pjesë e SUMP-it të tyre.

Projekti do të zhvillojë më tej teknikat e provuara të vlerësimit të cilësisë dhe qasjet e përdorura në projektet e mëparshme të suksesshme të BE si BYPAD, ADVANCE dhe QUEST për të zhvilluar mjetin (instrumentin) PARKPAD. Ai do të trajnojë dhe krijojë ekspertë të pavarur auditorë të PARKPAD-it.

Roli i auditorit do të përfshijë:

- ▶ Mbledhjen e informacionit bazë për situatën e përgjithshme të levishmërisë dhe parkimit në qytet
- ▶ Krijimin e një ‘grupi të palëve të interesuara’ (të përbërë nga anëtarë të zgjedhur, zyrtarë të qytetit, përdoruesit e transportit, shitësit me pakicë, etj.)
- ▶ Ndërmarrjen e një sërë takimesh lokale për të punuar drejt ndërtimit të një konsensusi mbi gjendjen aktuale në politikat dhe praktikat e parkimit të qytetit

Të gjitha këto do të reflektohen në Raportin e Cilësisë së Politikës së Parkingut. Nga kjo pikënisje e përbashkët, grupi i palëve të interest dhe auditori do të krijojnë së bashku një plan veprim PARKPAD të miratuar si pjesë e SUMP-it të qytetit, duke përfshirë paketën inovative, efektive dhe të pranueshme në nivel vendor të masave të parkimit.



# Merrni pjesë në Park4SUMP

Park4SUMP do të ftojë qytete në Evropë për të marrë pjesë në aktivitetet e trajnimit dhe webinaret mbi Politikat Kombëtare dhe Menaxhimit të Parkimit, si dhe evenete të trajnimit për auditor PARKPAD. Nëse dëshironi të merrni pjesë në këto aktivitete, na vizitonitë në: faqen e internetit, na ndiqni në Twitter dhe Facebook, ose bashkohuni me grupin tonë LinkedIn.

## Kontakt

Për më shumë informacion mbi Projektin Park4SUMP, kontaktoni koordinatorin e projektit Mobiel21:



**Patrick Auwerx**

[patrick.auwerx@mobiel21.be](mailto:patrick.auwerx@mobiel21.be)

**Projekti Park4SUMP filloi në Shtator 2018 dhe vijon deri në Mars 2022.**

[www.Park4SUMP.eu](http://www.Park4SUMP.eu)

 @civitas\_P4S



 Civitas Park4SUMP

 Park4SUMP

Përgjegjësia e vetme për përbajtjen e kësaj fletë palosje qëndron tek autorët. Përbajtja e saj jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin e Bashkimit Evropian. As Agjencia, as Komisioni European nuk janë përgjegjës për çdo përdorim që mund të bëhet nga informacionet e përfshira në të.



THE CIVITAS INITIATIVE  
IS CO-FINANCED BY THE  
EUROPEAN UNION

Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian, Programi Horizon 2020, kërkim dhe inovacion në kuadër të marrëveshjes së grantit nr. 769072.